



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/46
Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohen Projektligji për Bujqësi Organike.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/46

Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Për ndalimin e eksplotimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ndalimi do të zgjasë deri në 3 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Të gjithë operatorët që operojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi do t'u konfiskohet makineria eksplotuese, transportuese dhe materiali inert nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve, në pajtim me ligjin.
4. Policia e Kosovës, t'i ndalojë dhe legjitimojë të gjitha automjetet transportuese të ngarkuara me materiale inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve, kurse ndaj personave juridik dhe fizik të iniciohet procedurë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komunitatet përkatëse.
6. Obligohen palët e cekura në vendim që në afat sa më të shkurtër të nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit sipas fushave të përgjegjësisë si dhe të hartojnë Planin e Veprimit konform këtij Vendimi dhe legjislacionit në fuqi.
7. Obligohen të gjithë operatorët, subjekt i këtij vendimi që menjëherë të ndërpresin aktivitetin e tyre dhe të largojnë mekanizmin, pajisjet dhe stoqet me të cilat disponojnë deri me 3 janar 2012.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/46

Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Shenja e nacionalitetit Z6 për mjetet ajrore në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/46

Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/43 datë 19.10.2011, pika 1.16.9 në shumë 116.166.00 euro, reduktimi i ndarjes buxhetore nga programi i administratës qendrore nga kategoria e shpenzimeve kapitale të projektit "Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Turiçevc", rialokohen në projektin "Ndërtimi i SHM në Prishtinë e përgjithshëm". Në vend të emërimit të projektit "Ndërtimi i SHM në Prishtinë e përgjithshëm", të jetë "Ndërtimi i shkollës së mesme të re në Prishtinë".
2. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/43 datë 19.10.2011, pika 1.16.10 në shumë 146,500.00 euro, reduktimi i ndarjes buxhetore nga programi i administratës qendrore, nga kategoria e shpenzimeve kapitale nga projektit "Ndërtimi i SHKM në Ferizaj", rialokohen në projektin "Ndërtimi i Konviktit nr. 7". Në vend të emërimit të projektit "Ndërtimi i Konviktit nr. 7", të jetë "Ngritja e Infrastrukturës së re dhe renovimi i objekteve ekzistuese në Qendrën e Studentëve-QS".
3. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/43 datë 19.10.2011, pika 1.16.11 në shumë 50.000.00 € reduktimi i ndarjes buxhetore nga programi i administratës qendrore, nga kategoria e shpenzimeve kapitale nga Projektit "Ndërtimi i SHKM në Gjilan", rialokohen në projektin "Ndërtimi i Konviktit nr. 7". Në vend të emërimit të projektit nga "Ndërtimi i Konviktit nr. 7", të jetë "Ngritja e infrastrukturës së re dhe renovimi i objekteve ekzistuese në Qendrën e Studentëve-QS".

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/46
Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Znj. Edona Hajrullahu, emërohet Kryeshefe në Agjencinë për Barazi Gjinore.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. E emëruare nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/46
Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Transferin e mjeteve në shumë prej 9,770.00 euro, kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale, Programi i Administratës Qendrore.
2. Shuma e mjeteve sipas pikës 1. të këtij vendimi, transferohet nga projekti kapital "Riparimi ndërtesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe zyrave rajonale"- kodi nr. 12429, në projektin " Blerja e pajisjeve mbi 1,000" – kodi nr. 11225.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 8/46

Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 40,000.00 (dyzetmijë) euro për rivarrosjen dhe ngritjen e lapidarit të heroit Hysen Tërpeza, në Viti.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë dhe transferohen në Komunën e Vitisë.
3. Për rivarrosjen dhe ngritjen e lapidarit të heroit Hysen Tërpeza, themelohet një komision në Komunën e Vitisë, i cili udhëhiqet nga Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës z. Behgjet Pacolli.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Vitisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 9/46
Datë: 02.11.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2011, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare, në vlerë prej 660,000 (gjashtëqindgjashtëdhjetë mijë) euro për organizatat buxhetore, si vijon:
 - 1.1 Shuma prej 160,000 euro ndahet për komunën e Pejës, prej tyre 130,000 euro ndahen në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, kurse shuma prej 30,000 euro ndahet në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere;
 - 1.2 Shuma prej 200,000 euro ndahet për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, programi - Ngrohja Qendrore – për ngrohtoren e Gjakovës, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere;
 - 1.3 Shuma prej 200,000 euro ndahet për komunën e Klinës, kategoria ekonomike shpenzime kapitale;
 - 1.4 Shuma prej 100,000 euro ndahet për komunën Ranillug, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.
2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij Vendimi sigurohen nga programi me kod 232 – Shpenzimet e paparashikuara.
3. Obligohet Organizatat buxhetore përfituese nga ky vendim që në afatin prej pese ditësh nga nxjerrja e këtij vendimi të njoftojnë Ministrin e Financave për programin dhe kategorinë ekonomike ku duhet të ndahen këto mjete.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Organizatat Buxhetore të ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë